



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.885/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Besim Veliut kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Ferizajit, nga Subjekti Politik Ne Mundemi, me seli në Ferizaj, dega në Komunën e Ferizajit, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.885/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Besim Veliu kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Ferizajit, nga Subjekti Politik Ne Mundemi, me seli në Fereizaj, dega në Komunën e Ferizajit, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.885/2021 të paraqitur nga Besim Veliu kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Ferizajit, nga Subjekti Politik Ne Mundemi, me seli në Fereizaj, dega në Komunën e Ferizajit, me të cilën pretendon se në Vendvotimet VV 2507D/01R, VV 2507D/04R, VV 2507D/05R dhe VV 2501D/01R, ka pasur manipulime të votave dhe se kërkon nga PZAP që ta urdhëroj KQZ-në që të rinumroj fletvotimet në ato vendvotime.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Besim Veliu kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Ferizajit, nga Subjekti Politik Ne Mundemi, me seli në Fereizaj, dega në Komunën e Ferizajit, me të cilën kërkon rinumërim të votave në Vendvotimet nr. VV 2507D/01R, VV2507D/04R, 2507D/05R dhe 2501D/01R është i pa bazuar. Për faktin se në të vendvotimet 2507D/01R, 2507D/05R dhe 2501D/01R kandidati në fjalë ka vota, derisa në VV 2507D/04R nga të dhënat zyrtare u vërtetua se kandidati në fjalë ka zero vota, andaj Paneli,

vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.885/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.